

Betim Muço

WE
UPHEN
TTE



poezi

854-1

1178

Betim Muço

*NË UDHËN
TIME*



poezi

Shtëpia Botuese
«Naim Frashëri»

PËRHERË

(Në vend të parathënies)

*Përherë kam të them ca fjalë,
Prushërojnë në mua,
Shumohen e piqen
Dhe plasin sa dalin.*

*Kur i nis, them, u sosën,
Duart i shtrij në kozmos të shpirtit,
Të tjera fjalë gishtérinjtë m'i djegin.*

*Përherë kam të them ca fjalë,
Edhe kur do kujtoj se i kam thënë të
gjitha.*

DITË, JI E BUKUR

Ditë,

Ji e bukur, sot veçanërish,
Qoftë për një trill të zakonshëm zgjimi,
Që unë ta ndez cigaren te kongjilli i diellit
Dhe përrenjtë e kaltër qìellorë
T'i mbyt në vorbullat e syve.

Ditë,

Ji e bukur, sot veçanërish,
Që ta ndiej në papilat e gishtave, prekjen
e gjethit,

Dhe dora të bëhet sy

E syri të bëhet dorë

Dhe buza të pëshpërisë dashurinë e

njerëzve

Pa të cilët ky dhe do të ishte një hiç,

Planet i trishtuar i kotësisë së materies.

Ditë,

Ji e bukur, sot veçanërish

Tek unë çdo mëngjes

Rilindjeta.

PASMESNATE

Rrugë e pasmesnatës.

Fshesarët që fshijnë

Asfaltin pahitur nga pluñur i ditës.

Yjet vijnë afër.

Në majën e gjethit fle sythi i vesës.

Një e qeshur vajze rrokulliset tutje

Dy fshesaret plaka i hedhin romuze.

Paskan punë fshesarët.

Dhe kjo do të thotë:

Dita që kaloi, qe e gjithë e nis

1985

DIALEKTIKE

*Mos ma numëro ditën me orë,
Se më del e shkurtër,
E vogël, ajo
Rrahjet e ndryshme të zemrës
S'do t'i kuptosh,
Të asaj këmbane të thjeshtë
Më të shenjtë se shenjtëritë e botës.*

*Mos ma numëro vitin me ditë,
Se më del monoton
E i zhveshur.
Ashtu nuk m'i njeh dot netët pa gjumë,
Përpjekjen pa fund
Drejturës e së ndershmes.
Ashtu s'mi kuption kaq halle e dërtë,
Shqetësimin që bën fytyrën e vitit,
Atje ku zë fill koha e nesërme.*

*Mos ma numëro jetën me vite,
Se e rrafshëtë e zbehtë*

DINERATI

Ajo më del,
Si një shkretëtirë sylodhëse
E trishtë,
Si një moçal ujëndenjur që stuhinë s'e njeh.
Ashtu s'do m'i dish dallgët pa fund,
Dashurinë,
Gëzimin e luftës për jetë,
Rritjen time të bukur në kohë
Nga ajo që në ëndërr ka qenë
Tek ajo që e shoh, e dëgjoj dhe e prek.

MË IKU DITA...

*Më iku dita
Duke dëgjuar një köngë,
Duke ndier në ajër kërcitjen e krahut të
zogut.*

*Më iku dita
Në lodrën e ngjyrave
Që dielli krijon me qielin dhe tokën.*

*Më iku dita
Me një lule në duar,
Me një det në sy.*

*Më iku dita me njerëz të mirë
Duke marrë e dhënë me ta mjaltin e zemrës
(Se zemra prodhon më të çmueshmen gjë:
Dashurinë).*

*Më iku dita
Dhe s'kuptova se si
Por vetëm e ndjeva që jeta më shtohej.*

1982

P O E T I

*Zgjatem gjithmonë drejt diçkaje,
E gjithëjeta majë gishtave
Si pema që tenton qiellin.*

*Po a do të quhej dot jetë
Një rrojtje pa këtë synim?
Numërimi monoton i viteve
Si tespije në duart e plakut të shuar?*

*Zgjatem gjithmonë drejt diçkaje
I lumturuar nga mundimi i përpjekjes.*

1985